

RADU CRĂCIUN

**DIELLINA, NJË BIMË TRAKO-DAKE  
ME EMËR PROTO-ALBANOID**

**Abstrakt**

Termi trako-dak *diellina*, i cili i referohet emërtimit shqip “madërgonë, madërgonë e zezë (*Hyoscyamus niger*) dhe përmendet nga farmacisti grek Pedanius Dioskorides në listë në tij të bimëve mjekësore, jo vetëm shfaq një lidhje të qartë etimologjike me fjalën shqipe *diell*, por shërben edhe si dëshmi për zhvillimin fonetik nga një velare palatale tek një dhëmbore, një shndërrim fonetik karakteristik për shqipen.

Në pjesën qendrore-perëndimore të Gadishullit ballkanik, ku, sipas tezës së Eric Hamp-it, fliteshin të ashtuquajturat dialekte proto-albanoide, disa antroponime, toponime dhe glosa janë regjistruar me grafi alternative me dhëmbore dhe sibilante.

Shembujt e emrave me grafi alternative që përdorin dhëmbore dhe sibilante jo vetëm mund të lidhen me një fazë më të vjetër të gjuhës shqipe por i japin dhe një mbështetje të fuqishme tezës së Hamp-it mbi dialektet proto-albanoide.

**Fjalë kyçe:** *gjuha shqipe, Hamp, proto-albanoide, trako-dake, Dioskoridi, diellina*

Në mesin e glosave të gjuhës trake, të përmendura në punimet e specializuara, një vend të veçantë zënë emrat e bimëve mjekësore trako-dake (dialekti dak i gjuhës trake), të shënuara nga mjeku dhe farmakologu grek *Pedanius Dioskorides* (Dioscorides).<sup>1</sup> Gjuhëtari bullgar Dimitër Deçev (Dimitër Detschew)<sup>2</sup> bën analizën etimologjike të 26 fitonimeve nga një total prej 42 bimësh të konsideruara si dake nga Dioskoridi. Gjuhëtari Kolec Topalli

---

<sup>1</sup> Dioskoridi është autori i punimit të famshëm *Περὶ ὕλης ἰατρικῆς*, (“Për lëndët mjekësore”, latinisht *De materia medica*), i shkruar rreth vitit 77 mbas Krishtit.

<sup>2</sup> Dimitër Detschew, *Die thrakischen Sprachreste*, (Schriften der Balkankommission, Linguistische Abteilung 14), Österreichische Akademie der Wissenschaften, Wien, 1957, f. 564.

në librin “Fonetika historike e gjuhës shqipe”<sup>3</sup> përmend dy emra bimësh dake, të cilat i ndërlidh me fjalë të shqipes, të tilla, si: dak. *mantia* “manaferrë” – shq. *man* dhe dak. *amalusta* “kamomil” – shq. *ëmbël*. Gjithashtu mund të parashtrihen propozime për lidhje etimologjike me fjalë të gjuhës shqipe edhe në rastin e fitonimeve: dak. *sikoupnoux* “gjemi i gomarit” – shq. *thikë*, dak. *dun* “hithër” – shq. *dhunë*, dak. *toumbila* “Lewisia cotyledon” – shq. *tul*, dak. *skiare* “gjembaç” – shq. *shqerr*, *shkjerr*, dak. *salia* “tatulla” – shq. *thel*, dak. *dela* “bar, bimë” – shq. *dal*, dak. *diellina* “madërgona, kruspullaku (*Hyoscyamus niger*)” – shq. *diell*.<sup>4</sup>

Etimologjia e fitonimit të përmendur në fund, *diellina*, ka një rëndësi të veçantë, sepse reflekton një ndryshim fonetik karakteristik për gjuhën shqipe, në të cilën velaret palatale (grykoret qiellzore) të zëshme \***ǵ(h)**- shndërrohen në ndërdhëmboren **dh** ose në dhëmboren **d**, duke kaluar përmes fazave të ndërmjetshme të përfaqësuar nga afrikatja palato-alveolare e zëshme **j** [dz], afrikatja dhëmbore **dz** dhe më tej nga një fazë e fundit **dǵ**, si në vazhdim: \***ǵ(h)**- > **j** [dz] > **dz** > **dǵ** > **dh/d**.

Rrënja indoevropiane nga e cila rrjedh fjala *diell* është PIE \**ǵhélh3yo-* “i verdhë, i artë, i shkëlqyeshëm”, me një zhvillim \**ǵhélh3yo-* > parashqipja e lashtë \**jél̥ya-* > parashqipja \**dziella-* > \**dǵiella* > shq. *diell*<sup>5</sup>. Kjo zgjedhje, e përshtatshme si nga pikëpamja semantike ashtu edhe nga pikëpamja fonetike, e inkadron fjalën *diell* në një varg fjalësh shqipe të rëndësishme me dhëmbore

<sup>3</sup> Kolec Topalli, *Fonetika historike e gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Shtëpia Botuese "Dituria", Tiranë, f. 516.

<sup>4</sup> Dimitër Detschew, *Die thrakischen Sprachreste*, (Schriften der Balkankommission, Linguistische Abteilung 14), Österreichische Akademie der Wissenschaften, Wien, 1957, f. 559, dak. *sikou-pnoux* “gjemi i gomarit”, me pjesën *sikou-* nga PIE \**kē(i)-* “i mprehtë”; f. 549, dak. *dun* “hithër”, nga PIE \**dāu-* “djeg, torturon”; f. 561, dak. *toumbila* “Lewisia cotyledon”, me pjesën *tul-* nga PIE \**tēu-, t̥au-, teu̯ə-, t̥u̯ō-, t̥u̯-* “fryhet”; f. 560, dak. *skiare* “gjembaç”, nga PIE \**sker-* “pres”, shq. *shqerr*, *shkjerr*; f. 558, dak. *salia* “tatulla”, nga PIE \**kel-* “hell, shigjetë”; f. 547, dak. *-dela* “bar, bimë”, në fitonimin të përbërë *duo-dela*, nga PIE \**dhāl-* “lulëzon, gjelbëron”, shq. *dal*; dak. *diellina* “madërgona, kruspullaku (*Hyoscyamus niger*)” nga PIE \**dhel-* “shkëlqen, i ndritshëm”.

<sup>5</sup> Stefan Schumacher, Joachim Matzinger, *Die Verben des Altalbanischen: Belegwörterbuch, Vorgeschichte und Etymologie*, Shtëpia Botuese "Harrassowitz", Wiesbaden, 2013, f. 239.

- Joachim Matzinger, *Der altalbanische Text [E] Mbsuame e Krështerë (Dottrina Cristiana) des Lekë Matrënga von 1592, eine Einführung in die albanische Sprachwissenschaft*, Shtëpia Botuese "J.H.Röll", Dettelbach, 2006, f. 49.

- Vladimir Orel, *Albanian Etymological Dictionary*, Shtëpia Botuese "Brill", Leiden, 1998, f. 65.

- Kolec Topalli, *Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe*, Qendra e Studimeve Albanologjike, "Botimet Jozef", Tiranë, 2017, f. 384.

nistore **d-** që buron nga një velare palatale e zëshme e frymëtuar \***ǵh-**: *dardhë* < PIE \***ǵhord-**, *derr* < PIE \***ǵhoir-**, *dimër* < PIE \***ǵhei-**men, *dorë* < PIE \***ǵhērā**. Zgjedhja alternative e parashtruar nga studiuesi Eqrem Çabej<sup>6</sup>, i cili propozon një prejardhje nga rrënja PIE \**dhel-* “shkëlqen, i ndritshëm”, është kundërshtuar nga gjuhëtari Sergio Neri<sup>7</sup>, i cili vë në dukje faktin se kjo rrënjë është dytësore dhe buron nga PIE \**dhāl-* “lulëzon, gjelbëron”, duke pësuar një ndryshim kuptimor në gjuhët gjermanike dhe kelte. Duhet përmendur gjithashtu edhe fakti që nga rrënja \**dhāl-* rrjedh fjala shqipe *dal*, si edhe fjala trako-dake *-dela* me kuptimin “bar, bimë” që ndeshet në fitonimet trako-dake të përbëra *duo-dela* dhe *ko-dela*, duke patur një kuptim të afërt me fjalët armene që burojnë nga e njëjta rrënjë: *del* “bar, mjekim”, *dalar* “i gjelbërt, i njomë”. Bima me emrin *diellina*, “madërgona, kruspullaku (*Hyoscyamus niger*)”, i përket llojit të quajtur *solanum*, (sipas *sol* “diell” në latinisht), duke u emërtuar ashtu për shkak të gjethëve të saj të verdha. E njëjta ndërlidhje kuptimore haset edhe në rastin e emrit sllav të bimës, *belena*, me prejardhje nga PIE \**bhel-* “i ndritshëm, i bardhë”. Lloji *solanum retroflexum* është i njohur në gjuhën angleze me emrin “*sunberry* – kokrra e diellit”.

Nisur nga analizat e sipërpërmendura, parashtrojmë hipotezën: **a)** Ndryshimi fonetik i velareve palatale të zëshme, \***ǵ(h)-** > **j** [dz] > **dz** > **dð** > **ð** [dh]/**d**, së bashku me atë paralel që ka prekur velaret palatale të shurdhra, \***k̂(h)-** > **ć** [tɕ] > **ts** > **tθ** > **θ** [θ], është karakteristik jo vetëm për parashqipen<sup>8</sup> por për tërë grupin e dialekteve të përcaktuara nga gjuhëtari amerikan Erik Hamp me emërtimin “*proto-albanoid*”<sup>9</sup>, i shtruar kryesisht në një fashë qendrore-perëndimore të Gadishullit Ballkanik që përfshin rajonet: Dakia perëndimore, Mezia e Epërme, Dardania, Trakia perëndimore, Peonia dhe Iliria e mirëfilltë. **b)** Mbetjet gjuhësore të shënuara në pjesën qendrore dhe perëndimore të Gadishullit Ballkanik, kur përfaqësojnë terma që nga pikëpamja etimologjike vazhdojnë velaret palatale \***ǵ(h)-** ose \***k̂(h)-**, dëshmojnë

<sup>6</sup> Eqrem Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes. Bleu III: C – D*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1987, f. 241-242.

<sup>7</sup> Sergio Neri është bashkautor i fjalorit filologjik-etimologjik digjital të shqipes së vjetër (shek. XV-XVIII), shih Neri, Sergio / Demiraj, Bardhyl (2022): *diell -i*. në: DPEWA. “*Digitales Philologisch-Etymologisches Wörterbuch des Altalbanischen (XV.-XVIII. Jh.)*”,

<https://www.dpwa.gwi.uni-muenchen.de/dictionary/?lemmaid=14061>

<sup>8</sup> Stefan Schumacher, Joachim Matzinger, *Die Verben des Altalbanischen: Belegwörterbuch, Vorgeschichte und Etymologie*, Shtëpia Botuese "Harrassowitz", Wiesbaden, 2013, f. 237-239.

<sup>9</sup> Rexhep Ismajli, *Studime për historinë e shqipes në kontekst Ballkanik*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2015. (Shih: f. 13, f. 36, f. 157, f. 188-189 - diskutime për termin “*proto-albanoid*”, përdorur nga Hampi).

pasigurinë e autorëve grekë ose romakë në shënimin e afrikateve proto-albanoide **dz/dđ** ose **ts/tθ**, pasiguri që reflektohet përmes një luhatjeje të tipit **d/z** ose **t/s**.

Në mbështetje të pohimit të pikës a) do të përmendim disa shembuj shtesë domethënës për transmetimin e velares palatale të zëshme \*ĝ(h) përmes dhëmbores [d]. Antroponimi *Derdas* dhe toponimet *Darda-para*, *Dardania*, vazhdojnë sipas zgjedhjes etimologjike së parashtruar nga Deçevi<sup>10</sup> rrënjën PIE \**dhereĝh-* “mbaj, fort”, fakt i konfirmuar nga numri i madh i varianteve me luhatje **d/z**: *Derdidas*, *Derdipilus*, *Derdizanis*, *Dardizanus*, *Derzus*, *Derzeilas*, *Derzizenus*, *Derzenus*, *Darzalas*. Emri i fisit trak i vendosur në luginën e lumit Struma, *Dentheletae*, buron sipas Deçevit nga PIE \**ĝent-* “fis”, duke ndjekur zgjedhjen e parashtruar nga Norbert Jokli, i cili e lidh si variantin *-dentes*, edhe variantin me sibilante, *-zentes*, me rrënjën parësore PIE \**ĝen-* “lind”<sup>11</sup>.

E njëjta luhatje në shënimet e historianëve haset edhe në rastin e emrave të fiseve *Maidoi* në Trakinë perëndimore dhe *Maezei* në Dalmaci, të dyja me burim nga rrënja PIE \**meĝ-* “i madh, e madhe”<sup>12</sup>. Fenomeni ndeshet edhe tek trakët jugorë ku është shënuar mbiemri i perëndisë Apollo, *Derainos*, si edhe emri i fisit të të ashtuquajturit “trako-maqedonas” nga rajoni i Peonisë, *Derrones*, të dyja emërtime me një burim të mundshëm nga PIE \**ĝher-* “shkëlqen, ndrit”. Shembuj tek mesapët në jug të Italisë janë fjalët *deranthoa* “senat” nga PIE \**ĝer-* “plaket” dhe *dentan* “shenjë” nga PIE \**ĝen-* “njoh”<sup>13</sup>.

Për sa i përket pikës b) të hipotezës së shtruar më lart, shembujt e emërtimeve të shënuara me dhëmboren **d**, që në fakt korrespondojnë me afrikaten **dz** ose **dđ**, së bashku me shembujt që vazhdojnë velaren palatale të shurdhra \***k̂(h)**-, por të shënuara me dhëmboren **t** ose rastësisht me **d** ose **s**,

<sup>10</sup> Dimiter Detschew, *Die thrakischen Sprachreste*, (Schriften der Balkankommission, Linguistische Abteilung, 14), Österreichische Akademie der Wissenschaften, Wien, 1957, f. 118-119.

<sup>11</sup> Dimiter Detschew, *Die thrakischen Sprachreste*, (Schriften der Balkankommission, Linguistische Abteilung, 14), Österreichische Akademie der Wissenschaften, Wien, 1957, f. 125.

- Norbert Jokli në Ebert, M. *Reallexikon der Vorgeschichte*, 1924 – vël. 13, f. 292.

<sup>12</sup> Peter Anreiter, *Die vorrömischen Namen Pannoniens*, Shtëpia Botuese “Archaeolingua”, Budapest, 2001, f. 86.

- Ion Russu, *Illirii. Istoria. Limba si onomastica. Romanizarea*, Shtëpia Botuese e Akademisë së Republikës Socialiste të Rumanisë, Bukuresht, 1969, f. 224.

- Dimiter Detschew, *Die thrakischen Sprachreste*, (Schriften der Balkankommission, Linguistische Abteilung, 14), Österreichische Akademie der Wissenschaften, Wien, 1957, f. 280.

<sup>13</sup> Haas Otto, *Messapische Studien*, Heidelberg, Shtëpia Botuese “Carl Winter”, Heidelberg, 1962, f. 188.

Joachim Matzinger, *Einführung ins Messapische*, Wien, 2014, f. 79.

sipas varianteve *Tsierna/Tierna/Dierna*, përkatësisht *dinupula/sinupula*<sup>14</sup>, provojnë që shkrimi luhatës ka qenë shkaktuar nga prania e afrikateve dz/dđ përkatësisht ts/tθ në kuadër të dialekteve proto-albanoide.

Rrjedhimisht mund të konsiderohet si i pasaktë opinioni i Macingerit (Matzinger) për çështjen e pasqyrimit të afrikateve në gjuhën ilire, i cili, nga njëra anë pohon se: “Edhe në rastin e shënimit të germës gr. ζ/lat. z mbetet për të pyetur nëse këtu kemi të bëjmë me variantin e zëshëm të sibilantes s (e shënuar përmes gr. σ/lat. s), ose, gjithsesi kemi të bëjmë më saktë me afrikaten **ts**, përkatësisht me variantin e zëshëm **dz**.”<sup>15</sup>, por nga ana tjetër e përjashton në rastin e etimologjisë së antroponimeve *Bardus*, *Bardulis* dhe *Skenobardus* një lidhje me rrënjën PIE *\*bh̥arəǵ-* “i bardhë”: “do të ishte i pritshëm një shënim *\*barz-*”<sup>16</sup>. Të njëjtin opinion e ndeshim edhe në analizën etimologjike të toponimit *Dardania*: “Interpretimi i hasur shpesh i emrit tashmë antik *Dardania* nëpërmjet termit shqip “dardhë” nuk mund të mbështetet, sepse të gjitha etimologjitë e propozuara bazohen në leksema me IE *\*ǵh*, që në shqipen e lashtë u kthye në *\*dzh* dhe përkatësisht më vonë në *\*dz*, gjë që e riprodhuar në dokumentet greke/latine do të kërkonte një refleks përkatës, pra diçka të tipit <z>, <s>, ose të ngjashëm.”<sup>17</sup>

Interpretimi fonetik i pasaktë i mbetjeve gjuhësore të cilat reflektojnë një shënim luhatës të afrikateve proto-albanoide dz/dđ përkatësisht ts/tθ, ka çuar në përfundime të diskutueshme, të parashtruara nga gjuhëtarë të ndryshëm. Shembujt e përmendur më lart, tregojnë se si dhëmboret **t** dhe **d** ashtu edhe sibilantet **s** dhe **z** mund të reflektojnë në fakt afrikatet **dz/dđ** përkatësisht **ts/tθ**. Më shumë, shfaqja e shkrimit luhatës të llojit **d/z** ose **t/s** përbën një tregues të rëndësishëm për praninë e dialekteve “proto-albanoide” në Gadishullin Ballkanik.

<sup>14</sup> *Tsierna* < PIE *\*k̑er-no-* “akull”, Pokorny 1959, f. 573, *\*tsinupula* < *\*k̑yon-abolo-* “molla e qenit”, Blažek 1995.

<sup>15</sup> Joachim Matzinger, Andreas Lippert, *Die Illyrer*, Shtëpia Botuese “Kohlhammer”, Stuttgart, 2021, f. 148.

<sup>16</sup> Po aty, f. 158.

<sup>17</sup> Joachim Matzinger, *Die Albalkanischen Sprachen*, Wien, 2016, f. 42.

**BIBLIOGRAFI**

- Anreiter, P. (2001). *Die vorrömischen Namen Pannoniens*, Shtëpia Botuese "Archaeolingua", Budapest.
- Blažek, V. (1995). *Indo-European 'apple(s)'*, në *Studia minora Facultatis Philosophicae Universitatis Brunensis*, A. Řada jazykovědná (SFFBU), 44, č. A 43.
- Demiraj, B., Neri, S., Hackstein, O., Omari, A. (2017-2023). *DPEWA - Digitales Philologisch-Etymologisches Wörterbuch des Altalbanischen (XV.-XVIII. Jh.)*, München.
- Çabej, E. (1987). *Studime etimologjike në fushë të shqipes. Bleu III: C – D*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë.
- Detschew, D. (1957). *Die thrakischen Sprachreste*, (Schriften der Balkankommission, Linguistische Abteilung, 14), Österreichische Akademie der Wissenschaften, Wien.
- Ebert, M. (1924). *Reallexikon der Vorgeschichte* (15 vël.).
- Haas, O. (1962). *Messapische Studien*, Heidelberg, Shtëpia Botuese "Carl Winter", Heidelberg.
- Ismajli, R. (2015). *Studime për historinë e shqipes në kontekst Ballkanik*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë.
- Matzinger, J. (2006). *Der altalbanische Text [E] Mbsuame e Krështerë (Dottrina Cristiana) des Lekë Matrënga von 1592, eine Einführung in die albanische Sprachwissenschaft*, Shtëpia Botuese "J.H.Röll", Dettelbach.
- Matzinger, J. (2014). *Einführung ins Messapische*, Wien.
- Matzinger, J. (2016). *Die Altbalkanischen Sprachen*, Wien.
- Matzinger, J., Lippert, A. (2021). *Die Illyrer*, Shtëpia Botuese "Kohlhammer", Stuttgart.
- Orel, V. (1988). *Albanian Etymological Dictionary*, Shtëpia Botuese "Brill", Leiden.
- Pokorny, J. (1959). *Indogermanisches etymologisches Wörterbuch*, Shtëpia Botuese "Francke", München.
- Russu, I. (1969). *Illirii. Istoria. Limba si onomastica. Romanizarea*, Shtëpia Botuese e Akademisë së Republikës Socialiste të Rumanisë, Bukuresht.
- Schumacher, S., Matzinger, J. (2013). *Die Verben des Altalbanischen: Belegwörterbuch, Vorgeschichte und Etymologie*, Shtëpia Botuese "Harrassowitz", Wiesbaden.
- Topalli, K. (2007). *Fonetika historike e gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Shtëpia Botuese "Dituria", Tiranë.
- Topalli, K. (2017). *Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe*, Qendra e Studimeve Albanologjike, "Botimet Jozef", Tiranë.

## SUMMARY

### ***DIELLINA*, A THRACIAN-DACIAN PLANT WITH A PROTO-ALBANOID NAME**

The Thracian-Dacian term *diellina*, which refers to “henbane” and is mentioned by the Greek pharmacologist Pedanius Dioscorides in his list of medicinal plants, not only displays a clear etymological connection with the Albanian word *diell* meaning “sun”, but also serves as evidence for the phonetic evolution from a palatal velar to a dental, a characteristic phonetic change in Albanian.

In the central-western Balkan Peninsula, where, according to Eric Hamp's thesis, the so-called Proto-Albanoid dialects were spoken, certain anthroponyms, toponyms, and glosses have been recorded with alternating spellings using dentals and sibilants. This phenomenon reflects the uncertainty of the Greeks and Romans in transcribing the unfamiliar Proto-Albanian affricates.

The examples of names with alternating spellings using dentals and sibilants can not only be linked to an earlier stage of the Albanian language but provide strong support for Hamp's thesis about the Proto-Albanoid dialects.

